



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 470/7 prot.

Tiranë, më 18.9.2019

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr.169, datë 26.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Regleta Panajoti.
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 4.9.2019, është njoftuar vendimi nr.169, datë 26.6.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Regleta Panajoti, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr.169, datë 26.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, për periudhën prill 1995 – maj 2000, ka ushtruar detyrën si ndihmësgjyqtare¹ në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe nga viti 2000 e në vazhdim ushtron detyrën e gjyqtares pranë kësaj Gjykate.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin, znj. Regleta Panajoti, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim referuar si KLD), nga të cilat rezulton se:

3.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Regleta Panajoti”, ka referuar për subjektin, se:

- i. Ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, i ka referuar Komisionit “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës”.

3.3 KLD, bazuar në nenin 43, pika 2, e ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për aftësitë profesionale, nga analiza e të cilit, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku, Komisioni nuk ka gjetur elemente që mund të ngrenë dyshime për aftësinë profesionale apo elemente që cenojnë etikën e subjektit të rivlerësimit.

4. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *Pasi u hetua në mënyrë të thelluar mbi të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, Komisioni çmon se parregullsitë formale, të konstatuara në deklarime apo dukja e mungesës së të ardhurave në momente të caktuara përgjatë deklarimeve të pasurisë ndër vite, nuk ka pasur për qëllim fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurisë. Nisur nga rrethanat konkrete, bashkëpunimi i subjektit të rivlerësimit dhe gatishmëria e tij për të vënë në dispozicion me vërtetësi informacionin e kërkuar, Komisioni vlerëson se parregullsitë formale të konstatuara dhe mungesa e burimit të ligjshëm për shumën 870.873 lekësh nuk janë shkak i mjaftueshëm që plotëson nivelin e kërkuar për qëllim të ligjit nr. 84/2016... Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive formale, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të*

¹ Referuar ligjit nr. 7574, datë 24.6.1992, “Për organizimin e drejtësisë ...” (i shfuqizuar).

ardhurave të veta, si detyrim kryesor kushtetues i tij. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë [...] (f. 27 e vendimit). Në këto kushte, shumica e trupit gjykues të Komisionit, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, e ligjit nr. 84/2016.

4.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit Dh të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

4.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLD-ja, hetimin dhe vlerësimin e denoncimeve nga publiku, dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit 59, pika 1, germa “c”, e ligjit nr. 84/2016.

5. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, shumica e trupit gjykues të Komisionit, pasi relatori i çështjes ka votuar për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, referuar vlerësimin të kriterit të pasurisë, duke arsyetuar mbi parimin e proporcionalitetit dhe të vlerësimit objektiv, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, dhe për këto arsye, bazuar në germen “a”, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti.*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

7. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues/kontrollues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

10. Komisioneri Publik konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 169/2019, i Komisionit, provave dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat është paraqitur ankim në raste të njëjta apo për të cilat është depozituar rekomandim nga ana e një komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit

(referuar në vijim si ONM). Për këto rrethana të tilla ligjore e fakti, sikurse do të trajtojmë edhe në vijim, i jemi referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili, bazuar në nenin F të aneksit të Kushtetutës, është organi më i lartë gjyqësor, që vendos për vlerësimin përfundimtar të këtyre çështjeve.

11. Për sa më sipër, Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 169/2019, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

12. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashton si çështje për gjykim rrethana dhe fakte ligjore, lidhur me (*sipas radhës së trajtimit*): (i) pasaktësi dhe pamjaftueshmëri në deklarin e subjektit për dy pasuri të paluajtshme, të llojit apartament banimi; (ii) mungesë e dokumentacionit provues mbi burimin e ligjshëm të shumës prej 3.500.000 lekë, deklaruar si e ardhur nga puna në emigracion; (iii) mungesë e dokumentacionit provues për të ardhurat në shumën 200.000 lekë; (iv) deklarim i rremë për shitjen e pasurisë së paluajtshme e llojit truall, në Korçë (*rrethanë kjo, e cila lidhet edhe me etikën dhe figurën e magjistratit/subjektit të rivlerësimit*); (v) mundësinë financiare e huadhënësit ***.*** për ti dhënë hua subjektit shumën 10.000 EUR; (vi) mungesa e burimeve të ligjshme për depozitimin e shumës prej 12.000 euro në vitin 2007; si dhe (vii) deklarime të pasakta lidhur me posedimin e likuiditeteve *cash* ndër vite nga ana e subjektit të rivlerësimit.

13. Në referencë të përmbajtjes së pikës 2, të nenit 4, pikës 1, të nenit 59 dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmon se gjykimi i rrethanave ligjore dhe fakteve të mësipërme është i nevojshëm, me qëllim për të arritur në një vendimmarrje për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit nga ana e Kolegjit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

14. Në këto kushte, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7 të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 169, datë 26.6.2019, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

III.A. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A.1 Kontrolli i pasurisë

15. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

16. Subjekti i rivlerësimit, znj. Panajoti, rezulton se ka deklaruar: (i) në bashkëpronësi me ½ pjesë takuese, 2 (dy) pasuri të paluajtshme të llojit apartament banimi; (ii) në bashkëpronësi me 12/84 pjesë takuese, të 2 (dy) pasuri të paluajtshme të llojit truall; (iii) një autoveturë, si dhe (iv) likuiditete në formën e llogarive bankare dhe *cash*-it në banesë.

17. Për 2 (dy) pasuritë e paluajtshme të llojit apartament banimi, nga deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në “*Deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie*” (këtu e në vijim referuar si DV-2003, dorëzuar në ILDKPKI, më datë ***.3.2004), krahasuar me “*Deklaratën e pasurisë “Vetting”*” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), rezultojnë pasaktësi dhe pamjaftueshmëri për sa i përket: (i) vlerës së tyre dhe (ii) burimit të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive.

18. Pasuria nr. *, në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe 104.23 m², ndodhur në zonën kadastrale nr.***, Rruga e ***, Tiranë (në vijim referuar si “Apartament banimi 104 m²”)**

18.1 *Në D-Vett.*, subjekti deklaron: apartament banimi me sip. 104.23 m², vlera 47.150 USD dhe *burimi i krijimit*: (i) të ardhura nga emigracioni ekonomik dhe punësimi në Greqi; (ii) aktiviteti tregtar; (iii) shpronësim për interes publik; dhe (iv) punësimi i bashkëshortëve.

18.2 *Në DV-2003*, subjekti deklaron: apartament banimi me sip. 115 m², vlera 5.000.000 lekë dhe *burimi i krijimit*: (i) punë në emigracion; (ii) shitje pjesë të pasurisë trashëgimore (truall në Korçë, me sip. 814 m²); dhe (iii) pjesë të pasurisë së shitur nga ish-Kantina e Verës Korçë (pasuri e nënës, ***,***).

18.3 Nga krahasimi i të dyja deklaratave, konstatohet se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e pasurisë, pasi, referuar të dhënave zyrtare, rezulton se vlera e apartamentit 47.150 USD, e konvertuar në lekë, është në shumën 6.717.887 lekë² (ose 6.588.269 lekë³), si dhe lidhur me burimet e krijimit të saj, pasi rezulton se në DV-2003 subjekti nuk ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga punësimi i personit të lidhur, z. Panajoti, pranë shoqërisë “****” sh.p.k.

18.4 Në lidhje me pamjaftueshmërinë e deklaramëve, referuar “*Rezultateve paraprake të hetimit administrativ*”, Komisioni, bazuar në nenin Ç, pika 5 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës: (i) për të provuar me dokumentacion provues burimin e krijimit të të ardhurave të ligjshme në shumën prej 3.500.000 lekë, deklaruar si e ardhur nga emigracioni; (ii) burimin e krijimit të të ardhurave të ligjshme në shumën 200.000 lekë, pasi nuk rezultojnë të dhëna mbi fitimin e realizuar nga shoqëria “****” sh.p.k.; (iii) burimin e krijimit të të ardhurave të ligjshme nga shitja e pasurisë së paluajtshme në Korçë; pasi ka konstatuar mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në shumën prej – 3.820.219 lekë⁴. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka paraqitur shpjegimet dhe dokumentacionin e pretenduar prej saj si provues për të kundërtën.

18.5 Nga aktet në dosje, që dëshmojnë rrethanat e krijimit dhe burimit të të ardhurave të ligjshme për këtë pasuri, ndër të tjera, rezultojnë:

- (i) Kontratë shitje e datës ***.1.2002, me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., lidhur në Tiranë, noteri ***,***. Palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., palë blerëse *** e Regleta Panajoti, me objekt: pasuri e paluajtshme “apartament banimi”, me sipërfaqe 115 m², për çmimin 47.150 USD, paguar plotësisht jashtë zyrës noteriale, me vendndodhje Tiranë;
- (ii) Shkresë me nr. *** prot., datë ***.7.2018, e ZVRPP-së Tiranë, e cila konfirmon në bashkëpronësi pasurinë me nr. ***, zona kadastrale ***, e llojit apartament me sipërfaqe 104.23 m², shoqëruar me dokumentacion;
- (iii) Shkresë me nr. *** prot., datë ***.7.2018, e ZVRPP-së Korçë, e cila konfirmon pasuri në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit znj. Panajoti, shoqëruar me dokumentacion;
- (iv) Shkresë me nr. *** prot., datë ***.10.2018, e Autoritetit Rrugor Shqiptar, lidhur me shpronësimin e pasurisë në emër të subjektit të rivlerësimit znj. Panajoti, shoqëruar me dokumentacion;

² Sipas arkivit të kurseve të këmbimit, të publikuar në: www.bankofalbania.org, kursi mesatar shtator 2001, kur subjekti ka konvertuar shumën prej rreth 5.700.000 lekë në 40.000 USD, të cilat janë përdorur më pas për kryerjen e pagesave, është 1 USD = 142.89 lekë, ndërsa për diferencën 7.150 USD është përdorur kursi mesatar i muajit janar 2002, i publikuar në: www.bankofalbania.org, duke qenë se në këtë muaj është bërë pagesa e kështit të fundit, 1 USD = 140.18 lekë.

³ Kjo vlerë vjen si rezultat i konvertimit të shumës 47.150 USD me kursin që rezulton si mesatare aritmetike e kurseve të publikuara në: www.bankofalbania.org, për datat 20.10.2001, 4.1.2002 dhe 14.1.2002, datat sipas mandateve të pagesave të kryera për këtë pasuri, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit.

⁴ Referohuni rezultateve të hetimit paraprak, f. 8.

- (v) Shkresë me nr. *** prot., datë ***.11.2018, e Degës së Arkivit Tiranë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, vërtetim për të ardhurat e personit të lidhur z. Panajoti (bashkëshorti), për periudhën shkurt 1997- dhjetor 2010, si dhe për vitet në vijim;
- (vi) Shkresë me nr.*** prot., datë ***.10.2018, e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në Ministrinë e Mbrojtjes, për personin e lidhur, z. Panajoti (bashkëshorti);
- (vii) Shkresë me nr. *** prot., datë ***.8.2018, e Qendrës Kombëtare të Biznesit, lidhur me personin e lidhur, z. Panajoti (bashkëshorti);
- (viii) Fotokopje të disa faqeve të pasaportave, të lëshuara në vitin 1995 dhe disa vizave për subjektin e rivlerësimit, znj. Panajoti dhe personit të lidhur, z. Panajoti (bashkëshorti).

18.6 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, pas analizës së bërë, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit [...] ka pasur mundësinë e shpenzimit prej 47.000 USD për blerjen e apartamentit, konkluzion që bazohet në: (i) dokumentacionin e paraqitur për të ardhurat nga punësimi nga emigracioni në Greqi (sezonal dhe i plotë) dhe arsyetimin logjik mbi këto të ardhura; (ii) të ardhurat nga shpronësimi publik në shumën 720.000 lekë; (iii) të ardhurat nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit, në shumën prej 200.000 lekë; (iv) të ardhurat nga punësimi i bashkëshortëve në shumën 4.249.568 lekë; dhe (v) të ardhura të tjera nga vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në shumën 126.554 lekë [...] (f. 13 e vendimit, prg. 3 dhe 4).

19. Komisioneri Publik çmon se ky konkluzion i Komisionit nuk qëndron, pasi nuk bazohet në një vlerësim të drejtë ligjor të të gjitha provave, fakteve dhe rrethanave të vërtetuara nga aktet e administruara në dosje, si dhe me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për interpretimin dhe zbatimin e nenit D të aneksit të Kushtetutës. Në vijim të arsyetimit, për burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave të ligjshme për këto pasuri, parashatrojmë qëndrimin, bazuar mbi të cilin Komisioneri Publik ndan një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni.

20. Për të ardhurat nga emigracioni ekonomik dhe punësimi në Greqi

Subjekti i rivlerësimit, znj. Panajoti, pretendon se të ardhurat nga emigracioni i ka pasur të depozituara në sistemin bankar. Ka rezultuar se personi i lidhur, z. Panajoti, ka pasur llogari pranë *** Bank. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, veprimi i parë në këtë llogari daton në ***.1.1998, depozitim në *cash* i shumës 160.000 lekë.

Prej datës ***.1.1998, deri në momentin e blerjes së “*Apartament banimi 104 m²*” (tetor 2001-janar 2002), llogaritë e bashkëshortit të subjektit pranë kësaj banke janë shtuar me depozitime të herëpashershme në *cash* të shumave, që variojnë nga 60.000 lekë deri 1.000.000 lekë.

20.1 Të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Panajoti, si të krijuara nga emigracioni, për periudhën 1991-2001

Në lidhje me verifikimin e burimit të ligjshëm për krijimin e këtyre të ardhurave të ligjshme, të pretenduara si të siguruara nga emigracioni, nga shqyrtimi i provave dhe akteve në dosje, për subjektin e rivlerësimit, znj. Panajoti, rezulton se:

- (i) Mungon dokumentacioni justifikues ligjor për masën e të ardhurave të ligjshme nga puna e pretenduar në emigracion, për periudhën 1991-2001⁵ (në dhjetor 2001 dhe janar 2002 janë bërë pagesat e pasurisë “*Apartament banimi 104 m²*”).
- (ii) Libreza e punës e subjektit të rivlerësimit referon kohë të plotë punësimi për periudhën *** mars 1995 – *** prill 1995, juriste në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, *** prill 1995- *** maj 2000, ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, periudha maj 2000 e në vijim, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në të tilla rrethana punësimi të pandërprerë, nuk ka ekzistuar mundësi emigracioni ekonomik apo punësimi sezonal, siç arsyeton Komisioni.

⁵ Përgjigje pyetësores nr. 2, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë ***.11.2018, f. 3.

- (iii) Sipas fotokopjes së pasaportës së subjektit të rivlerësimit, me datë lëshimi *** qershor 1995, rezultojnë disa viza të lëshuara me afat 90 dhe 180-ditor, konkretisht për periudhat korrik 1997, tetor 1997, mars 1999, shtator 1999, si dhe disa vula hyrje – dalje (periudha ditore, deri në javore). Nuk ka asnjë provë, dokumentacion që të provojë punësimin në këto periudha kohore.
- (iv) Sipas nenit 1, të ligjit nr. 7574, datë 24.6.1992, “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile”, Gjykata e Rrethit, si hallkë themelore e sistemit gjyqësor shqiptar, përbëhej nga Kryetari, zëvendëskryetarët, gjyqtarët dhe ndihmësgjyqtarët, të cilët emëroheshin dhe shkarkoheshin nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Pra, subjekti i rivlerësimit, znj. Panajoti, në cilësinë e ndihmësgjyqtarit, që në muajin prill 1995, ka qenë pjesë e sistemit gjyqësor.

20.1.1 Në përfundim për sa më sipër, nuk provohet me dokumentacion ligjor justifikues, puna në emigracion dhe masa e të ardhurave të ligjshme të krijuara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Panajoti.

20.2 Të ardhurat e pretenduara të personit të lidhur, z. Panajoti, si të krijuara nga emigracioni, për periudhën 1991-2001

Në lidhje me verifikimin e burimit të ligjshëm për krijimin e këtyre të ardhurave të ligjshme, të pretenduara si të siguruara nga emigracioni, nga shqyrtimi i akteve në dosje, për personin e lidhur, z. Panajoti, nga shqyrtimi i provave dhe akteve në dosje, rezulton se:

- (i) Mungon dokumentacioni justifikues ligjor për masën e të ardhurave të ligjshme të realizuara nga puna e pretenduar në emigracion, për periudhën 1991-2001. I vetmi dokumentacion i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës për këtë fakt të pretenduar, është “*Certifikatë e regjistrimit të një personi të siguruar të drejtpërdrejtë*”, me datë efektive ***.10.1995, lëshuar nga Amza e të Siguruarve e Njësisë ***, Greqi.
- (ii) Libreza e punës referon kohë të plotë punësimi, si oficer aktiv i Forcave të Armatosura shqiptare për z. Panajoti, në periudhën gusht 1986 - prill 1995, pranë Ministrisë së Mbrojtjes⁶. Në të tilla rrethana, nuk ka ekzistuar mundësi emigracioni ekonomik apo punësimi sezonal, siç arsyeton Komisioni. Gjithashtu, sipas nenit 2, germa “dh”, e ligjit nr. 7517, datë 8.10.1991, “Për punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë territorit të Shqipërisë”, ndalohej ushtrimi i së drejtës së punësimit jashtë territorit të Shqipërisë për “*të gjithë pjesëtarët e forcave të armatosura*”.
- (iii) Shkresa e ISSH-së⁷ referon kohë të plotë pune për periudhën shkurt 1997-2010 pranë Bankës ***, pra nuk ka se si të ketë ekzistuar emigracion ekonomik apo punësim sezonal, siç arsyeton Komisioni.
- (iv) Për periudhën korrik 1995-nëntor 1996, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, rezulton se ka qenë administrator dhe ortak i shoqërisë “****” sh.p.k.⁸, ku, më datë ***.11.1996, është larguar si ortak i shoqërisë dhe ka shituar kuotat e kapitalit, pra nuk duhet të ketë ekzistuar mundësi për emigracion ekonomik apo punësim sezonal, siç arsyeton Komisioni.
- (v) Vetëm periudha nëntor 1996-janar 1997 (3 muaj) është periudha për të cilën nuk ka dokumentacion justifikues për punësimin e z. Panajoti në Republikën e Shqipërisë.

⁶ Libreze pune, në emër të z. ***, ***, me detyrë oficer aktiv në Ministrinë e Mbrojtjes, për periudhën ***.8.1986 - ***.4.1995.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë ***.11.2018, e Degës së Arkivit Tiranë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për periudhën shkurt 1997- dhjetor 2010, si dhe për vitet në vijim.

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë. ***.8.2018, e QKB-së, dhe shkresë nr. *** prot, datë. ***.10.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër.

(vi) Sipas fotokopjes së pasaportës të personit të lidhur, bashkëshortit, datë lëshimi është *** qershor 1995 dhe viza është lëshuar më datë ***.1.1997, për një afat 180 ditë, pra nuk ka se si të ketë ekzistuar emigracion ekonomik i plotë për periudhën 1996-1997, siç arsyeton Komisioni.

20.2.1 Në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës një dokument: “Libri i Shëndetit” të djalit ***.***, të lëshuar nga Kujdesi Social dhe Sigurimet Shoqërore, shteti grek, të përkthyer në gjuhën shqipe.

20.2.2 Komisioni ka parashtruar se: [...] *Bazuar në kuadrin ligjor të Republikës së Greqisë, rezulton se të siguruarit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (IKA) dhe anëtarëve të familjes së tij, i jepet mbulim shëndetësor në rast se i siguruari ka realizuar 50 ditë punë gjatë vitit paraardhës. Pajisja e djalit të subjektit me këtë libër të shëndetit të fëmijës të krijon bindjen se bashkëshorti i subjektit ka qenë i siguruar dhe nga ky sigurim djali i tyre ka përfituar librin e shëndetit. Pra, sipas kësaj prove (librit të shëndetit) provohet edhe një herë periudha e emigrimit në Greqi dhe qenia e familjes së subjektit në *** të Greqisë, pikërisht në vitin 1995, e cila përkon edhe me provën shkresore të regjistrimit të bashkëshortit të subjektit, z. ***.***, si i punësuar në Greqi [...].*

20.2.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, arsyetimi si mësipërm i Komisionit nuk qëndron. Dokumenti i paraqitur nga subjekti nuk përbën provë për të vërtetuar periudhën e plotë të punësimit të pretenduar apo masën e të ardhurave të përfituara nga ky punësim. Për më tepër, sipas edhe vetë këtij argumenti të përdorur, sigurimi ka ndodhur për një masë 50 ditë pune dhe rezulton ndërkohë se shtetasi ***.***, ka lindur më datë ***.06.1995, Tiranë, pra familja ka qenë e vendosur në Shqipëri.

20.2.4 Në përfundim për sa më sipër, nuk provohet me dokumentacion ligjor justifikues, puna në emigracion, si burimi ligjshëm për krijimin e shumës prej 3.500.000 lekë, si të ardhurave të ligjshme për krijimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, konkluzioni se periudha e rivlerësimit, të cilën citon Komisioni, sipas nenit 3, pika 12 e ligjit nr. 84/2016, në korrelacion me personin e lidhur z. Panajoti, nuk gjen zbatim në rastin konkret për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë.

21. Për të ardhurat nga aktiviteti tregtar i personit të lidhur, z. Panajoti

21.1 Në *D-Vett.*, për herë të parë, subjekti i rivlerësimit, znj. Panajoti, ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti i personit të lidhur, z. Panajoti, në shoqërinë “****” sh.p.k., në vlerën 200.000 lekë, për periudhën 1995-1996.

21.2 Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se, sipas dokumenteve të përcjella nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, nuk rezultojnë të dhëna mbi fitimin e realizuar në vitet 1996 - 1997, kohë në të cilën subjekti i rivlerësimit, znj. Panajoti, ka deklaruar burimin e të ardhurave të fituara nga aktiviteti tregtar në këtë shoqëri. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna mbi shpërndarje dividendi apo të fitimit të realizuar nga shoqëria në fjalë.

21.3 Sipas akteve të përcjella nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë⁹, shoqëria është krijuar më datë ***.7.1995, me kapital themeltar 100.000 lekë, ku personi i lidhur, z. Panajoti, ka qenë në rolin e ortakut me 50% të kuotave dhe në funksionin e administratorit të shoqërisë. Me vendim të datës ***.11.1996, është vendosur largimi i ortakut personit të lidhur z. ***.*** dhe shitja e kuotave të kapitalit të tij ortakut tjetër (për këtë fakt nuk disponohet asnjë dokumentacion mbi çmimin e shitjes apo kryerjen e transaksionit).

21.4 Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Panajoti, rezulton se periudha e pretenduar e punësimit të personit të lidhur pranë kësaj shoqërie përkon me

⁹ Shkresa nr. ***, datë ***.10.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë.

periudhën e pretenduar të emigracionit të rregullt (jo sezonal), të deklaruar gjatë hetimit administrativ¹⁰. Nga këto deklarime, subjekti i rivlerësimit është kontradiktor në lidhje me faktin nëse gjatë kësaj periudhe kohore, personi i lidhur, z. Panajoti, ka qenë në emigracion apo ka punuar/ndihmuar (të kunatin), si ortak në shoqërinë “****” sh.p.k.

21.5 Subjekti i rivlerësimit, znj. Panajoti, deklaron¹¹ se të ardhurat prej 200.000 lekë (të deklaruara në D-Vett) janë të ardhura të përfituara në formën e pagës për periudhën rreth 1 vit e gjysmë, për shumën 10.000 lekë në muaj, për të cilat nuk ka paraqitur asnjë provë për sa ka deklaruar mbi përfitimin e këtyre të ardhurave apo shlyerjen e detyrimeve tatimore, për t’u konsideruar të ardhura të ligjshme, në referencë të pikës 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

21.6 Në përfundim për sa më sipër, nuk provohet me dokumentacion ligjor justifikues e ardhura e deklaruar në vlerën 200.000 lekë. Për më tepër, nga shkresa nr. ***, e datës ***.10.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër, rezulton se kjo shoqëri ka kaluar në status pasiv prej datës ***.7.1996.

22. Jurisprudenca e Kolegjit, lidhur me të ardhurat e ligjshme me burim nga remitancat (të ardhurat nga emigracioni)

22.1 Kolegji ka trajtuar në disa vendime të tij pretendimet e ngritura lidhur me të ardhurat e ligjshme me burim nga remitancat (të ardhurat nga emigracioni), si në vendimet (JR) nr. 9/2018, (JR) nr.12/2018 dhe (JR) nr. 6/2019, duke krijuar në këtë mënyrë jurisprudencën vijuese:

- (i) Në vendimin nr. 9/2018, Kolegji përcakton se: [...] *nuk rezulton që të jetë e provuar shuma ose të ardhurat e pretenduara se janë realizuar nga emigracioni...trupit gjykues të Kolegjit nuk i rezultoi e provuar se si janë transferuar këto kursime në Shqipëri, në përmbushje të detyrimit të parashikuar në pikën 21 të udhëzimit të sipërcituar të ILDKPKI-së. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit, në bazë të dokumentacionit të administruar në dosje, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ishte në kushtet e pamundësisë objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të vërtetuar zhdukjen apo humbjen e dokumentacionit justifikues për të ardhurat e ligjshme, sipas pretendimeve të ankueses [...].*
- (ii) Në vendimin nr. 12/2018, Kolegji përcakton se: [...] *lidhur me pretendimin e subjektit për të justifikuar të ardhurat nga huat e dhëna nga personat e tjerë të lidhur, bazuar në remitancat që emigrantët shqiptarë kanë sjellë në familjet e tyre, nga të cilat pretendon se ka përfituar dhe ai vetë, trupi gjykues vëren se remitancat tregojnë se ka pasur fluks parash, të cilat kanë hyrë dhe vazhdojnë të hyjnë në Shqipëri, por ato nuk janë provë në këtë gjykim... Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, të dhënë hua. Trupi gjykues vëren se argumenti i subjektit të rivlerësimit bie ndesh me nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 21 të udhëzimit të ILDKPKI-së nr. 4095, datë 10.10.2016. Këto akte ligjore dhe nënligjore kërkojnë nga subjektet e rivlerësimit dhe nga institucionet e rivlerësimit, personat e lidhur ose personat e tjerë të lidhur me ta, kur këta të fundit janë në kushtet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të provojnë me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore për to. Përveç sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se që ato të konsiderohen të ligjshme, duhet provuar edhe mënyra se si ato kanë mbërritur te subjekti i rivlerësimit [...].*

¹⁰ Shihni pyetësorin nr. 2, përgjigje e pikës 3.1, si dhe materialin “Argumente, prova, dhe observime mbi rezultatin e hetimit”, f. 16.

¹¹ Po aty.

(iii) Në vendimin nr. 6/2019, Kolegji përcakton se: [...] *së pari, sa u takon të ardhurave me burim nga emigracioni, trupi gjykues mban parasysht qëndrimin e Kolegjit në një vendimmarrje të mëparshme, sipas së cilës jo gjithmonë remitancat mund të konsistojnë në dërgesa të vlerave monetare të krijuara nga burime të ligjshme dhe të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në kuptim të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, lidhur me përmbushjen e detyrimeve tatimore përkatëse. Për rrjedhojë, me qëllim që remitancat të vlerësohen në gjykimet pranë Kolegjit, nevojitet që ato të provohen se janë dërgesa vlerash monetare të emigrantëve shqiptarë në vendin e origjinës, të cilat janë realizuar nga burime të ligjshme dhe për të cilat janë përmbushur detyrimet përkatëse tatimore në vendin e krijimit. Për efekt të provueshmërisë së kritereve të sipërcituara, në përputhje me nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin që, në rastet e deklarimit si burim krijimi të pasurive të tyre, të ardhurat nga emigracioni, të paraqesin të gjitha dokumentet që provojnë burimin dhe justifikojnë ligjshmërinë e tij. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se kërkesat e pikës 21 të udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, në zbatim të parashikimit kushtetues të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, përmbushen vetëm në saje të administrimit të dokumentacionit që provon ekzistencën e: (i) një burimi real të ardhurash dhe (ii) vlerën e të ardhurave të krijuara nga personi deklarues dhe jo të mundësisë objektive për t'u zënë me punë, që ekuivalentohet me mundësinë potenciale për të krijuar të ardhura gjatë periudhës së deklaruar [...]*

22.2 Komisioni, në arsyetimin e vendimit në rastin konkret, lidhur me burimin e ligjshëm të pasurisë me origjinë të ardhurat e krijuara në emigracion, ndër të tjera, parashtron se: [...] *për të ardhurat e përfituara nga puna, tatimi mbahet në burim nga punëdhënësi, sidomos kur janë prodhuar jashtë shtetit dhe në shuma që janë afër pragut minimal të pagës mujore minimale, që përjashtohet nga taksat dhe tatimet, dhe nuk është në përgjegjësinë e të punësuarit dhe dispozitave ligjore të dala në zbatim të saj [...].* (f. 9 e vendimit, prg. 3).

22.3 Komisioneri Publik, përveç jurisprudencës së Kolegjit të cituar sa më lart, por edhe vendimeve të tjera që trajtojnë specifikisht të ardhurat e ligjshme të pretenduara se kanë si burim të ligjshëm një marrëdhënie punësimi¹², vlerëson se ky arsyetim i përdorur nga Komisioni shkarkon subjektet nga detyrimi ligjor i paraqitjes së dokumentacionit ligjor justifikues për ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave, duke i "hamendësuar" si të ligjshme për sa kohë janë të ardhura nga punësimi, për më tepër afër pragut minimal të pagës mujore. Gjithashtu, ky arsyetim është kontradiktor me vetë konkluzionin përfundimtar të Komisionit për këto të ardhura, pasi nga të ardhurat afër pragut minimal nuk ka se si të sigurohen kursime, që në rastin konkret janë edhe të konsiderueshme.

23. Pamundësia objektive e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit dhe e pranuar nga Komisioni, sipas nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 84/2016

23.1 Komisioni, lidhur me pamundësinë objektive të subjektit konkret të rivlerësimit dhe shkarkimin nga përgjegjësia për të paraqitur dokumentacion mbi sigurimin e të ardhurave nga emigracioni, ndër të tjera, parashtron se: [...] *Komisioni mban parasysht edhe faktin se nisur nga kalimi i një periudhe kohore kaq të gjatë, eventualisht e gjen të drejtë kërkesën për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga detyrimi për paraqitjen e dokumenteve që justifikojnë ligjshmërinë e krijimit të pasurive, sipas nenit 32, pika 2, e ligjit nr. 84/2016, duke vlerësuar të gjitha përpjekjet e tij për të provuar deklarimet e bëra [...]* (f. 9 e vendimit, prg. 4).

¹² Vendim i Kolegjit (JR) nr. 7/2019.

23.2 Komisioneri Publik vlerëson se pamundësia objektive nuk mund të jetë situatë që bazohet në një perceptim të përgjithshëm, por ajo është një gjendje faktike, e cila konfirmohet nga institucioni përgjegjës/subjekti respektiv përgjegjës, për të lëshuar dokumentacionin përkatës, që provon burimin e krijimit të pasurisë, burim, i cili shfaqet qoftë për të dëshmuar të ardhurat si burim krijimi, ashtu edhe akti formal formues i së drejtës së pronësisë. Nëse ky dokument ka humbur, është zhdukur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër, kjo duhet në çdo rast të provohet me dokumentacion justifikues “negativ”, që do të thotë se autoriteti përgjegjës për dokumentacionin justifikues konfirmon se gjendemi para rasteve të parashikuara në këtë dispozitë që dokumenti ka humbur, është zhdukur, nuk mund të bëhet përsëri apo nuk mund të merret në rrugë të tjetër. Hamendësimi dhe perceptimi i përgjithshëm, i bazuar në prova dhe fakte, nuk mund të shërbejnë për të mbështetur një argumentim ligjor.

23.3 Nga aktet në dosjen e subjektit të rivlerësimit, përveç dokumentit nga “Amza e të Siguruarve e Njësisë ***”, Greqi, e paraqitur me vulë apostile dhe e përkthyer në shqip, nuk rezulton ndonjë përpjekje nga ana e subjektit të rivlerësimit për të siguruar dokumentacion nga shteti grek, për të justifikuar të ardhurat e ligjshme, të krijuara nga punësimi në emigracion. Të gjitha shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Panajoti, ngelen në nivelin deklarativ, të pashoqëruara me ndonjë përpjekje efektive të kryer prej saj në këtë drejtim.

24. Në përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, për pasurinë “apartament banimi me sip. 104 m²”, Tiranë, në referencë të nenit D, pika 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për vlerën e deklaruar në D-Vett. dhe DV-2003; nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave e ligjshme nga puna në emigracion, në shumën e pretenduar prej 3.500.000 lekë, si dhe të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i shoqërisë “**” sh.p.k., në shumën 200.000 lekë, gjithsej për një vlerë 3.700.000 lekë.**

25. Pasuria nr. *, në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe 64.8 m², ndodhur në zonën kadastrale nr. ***, Rruga e ***, Tiranë (në vijim referuar si “Apartament banimi 64 m²”)**

25.1 *Në D-Vett.*, subjekti deklaron: apartament banimi me sip. 64.80 m², vlera 50.000 euro dhe burimi i krijimit: (i) punësimi; (ii) shitja e pasurisë së paluajtshme në Korçë; dhe (iii) kontrata e huas (10.000 euro).

25.2 *Në DV-2007*, subjekti deklaron: apartament banimi me sipërfaqe 74.6¹³ m², vlera 50.000 euro dhe burimi i krijimit: nuk specifikohet në rubrikën e pasurive, ndërsa në rubrikën e detyrimeve përshkruhet pagimi i shumës prej 40.000 euro.

25.3 Nga krahasimi i dy deklaratave, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Panajoti, nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë: “Apartament banimi 64 m²” në DV-2007. Gjithashtu, në DV-2007, ka deklaruar edhe mbylljen e dy depozitave bankare njëra pranë *** Bank, në shumën rreth 20.000 USD dhe tjetra pranë *** Bank, në shumën 12.000 euro.

25.4 Për depozitën në *** Bank, në shumën 12.000 euro, rezulton se është krijuar dhe tërhequr cash brenda të njëjtit vit kalendarik, 2007. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, kjo shumë duhet të analizohet së bashku me mundësinë e subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme pasurinë “Apartament banimi 64 m²”.

25.5 Referuar “Rezultateve paraprake të hetimit administrativ”, Komisioni, bazuar në nenin Ç, pika 5 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të provuar të kundërtën për: (i) burimin e ligjshëm të huas së

¹³ Kontratë noteriale sipërmarrje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.10.2007, sipërfaqe e brendshme 64.80 m².

deklaruar në vlerën 10,000 euro; (ii) burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura për krijimin e depozitës së kursimit në vlerën 20.000 USD, si një nga burimet e deklaruara të përdorura për pagesat e pasurisë “Apartament banimi 64 m²”; si dhe (iii) mbi burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 12.000 euro, të depozituar *cash* në llogarinë bankare në shkurt 2007, pranë *** Bank¹⁴.

25.6 Nga aktet e administruara në dosje që dëshmojnë rrethanat e krijimit dhe burimit të të ardhurave të ligjshme për këtë pasuri, ndër të tjera, rezultojnë:

- (i) Kontratë shitje, e datës ***.11.2012, me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., lidhur në Tiranë, Noteri ***.***. Palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., palë blerëse *** e Regleta Panajoti, me objekt: shitje pasuri e paluajtshme “Apartament banimi”, me vendndodhje në Tiranë, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 64.8 m², për çmimin 50.000 euro, paguar plotësisht jashtë zyrës noteriale.
- (ii) Kontratë shitje e datës ***.3.2004, me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., lidhur në Korçë, Noteri ***.***. Palë shitëse znj.***.***, subjekti R. Panajoti (e përfaqësuar me prokurë), z.***.***, me palë blerëse z.***.***. Kontrata ka objekt shitje pasuritë e paluajtshme “truall”, me nr. ***, *** (ish-***¹⁵), ***, me vendndodhje në Korçë, z. k. ***, kundrejt çmimit 1.900.000 lekë, paguar plotësisht jashtë zyrës noteriale.
- (iii) Kontratë shitje për një kohë të ardhme, e datës ***.5.2003, me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., lidhur në Korçë, Noteri ***.***. Palë shitëse znj.***.***, subjekti R. Panajoti, z. ***.***, me palë blerëse z.***.***. Kontrata ka objekt shitje pasuritë e paluajtshme “truall”, me nr.***, ***, ***, me vendndodhje në Korçë, z. k.***, kundrejt çmimit 2.000.000 lekë, shumë e cila është marrë në dorëzim nga shitësit në prani të noterit.
- (iv) Deklaratë noteriale e subjektit R. Panajoti, e datës ***.11.2018, me nr.*** rep., dhe nr. *** kol., bërë në Tiranë, noteri ***.***. Deklarata ka për objekt: “*Deklarimi i çmimit të shitjes për një transaksion në të shkuarën*”, ku subjekti R. Panajoti deklaroi se shuma e përfutur nga shitja e truallit, sipas kontratave të sipërcituara, ka qenë 1.775.200 lekë.
- (v) Deklaratë noteriale e z.***.***, e datës ***.11.2018, me nr.*** rep., dhe nr. *** kol., bërë në Tiranë, noteri ***.***. Deklarata ka për objekt: “*Për kthim huaje*”, ku z.***.*** shprehet se shuma prej 10.000 euro, e dhënë me kontratë huaje më datë ***.12.2007 z.***.***, i është kthyer totalisht.
- (vi) Akte shkresore mbi transaksione të kryera nga z.***.*** dhe ***.***, në lidhje me huan 10.000 euro.

25.7 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ për pasurinë apartament banimi 64 m,² ka parashtruar se: [...] *në vlerësimin tërësor të kësaj pasurie, Komisioni çmon se provat e paraqitura dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kanë arritur nivelin e kërkuar të provueshmërisë dhe besueshmërisë. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si dhe ata të tjerë të lidhur, kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurisë objekt hetimi nga të ardhurat e realizuara në mënyrë të ligjshme [...]* (f. 20 e vendimit, pika 15.5).

25.8 Komisioni, lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të shumës 12.000 euro, depozituar pranë *** Bank, ka parashtruar se: [...] *Pasaktësia në deklaram e gjendjes cash nuk mund të jetë shkak i mjaftueshëm për të provuar mungesën e të ardhurave, mbështetur edhe në faktin se aftësitë financiare për t’i pasur vërtetohen nga dokumentacioni i administruar... Nisur nga rrethanat konkrete, bashkëpunimi i subjektit të rivlerësimit dhe gatishmëria e tij për të vënë në dispozicion me vërtetësi informacionin e kërkuar, Komisioni vlerëson se parregullsitë formale të konstatuara dhe mungesa e burimit të ligjshëm për shumën 870.873 lekësh, nuk janë shkak i mjaftueshëm që plotëson nivelin e kërkuar për qëllim të ligjit nr. 84/2016 [...]* (f. 27 e vendimit, prg. 6).

¹⁴ Referohuni në f. 33 të rezultateve të hetimit.

¹⁵ ZVRPP Korçë konfirmon se pasuria nr. *** rrjedh nga ndarja e pasurisë nr. ***.

26. Komisioneri Publik, çmon se ky konkluzion i Komisionit nuk qëndron, pasi nuk bazohet në një vlerësim të drejtë ligjor të të gjitha provave, fakteve dhe rrethanave të vërtetuara nga aktet e administruara në dosje, si dhe me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, lidhur me elementët e dashjes apo qëllimit në deklarime. Në vijim të arsyetimit, parashtrojmë qëndrimin, bazuar mbi të cilin, Komisioneri Publik ndan një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni.

26.1 *Për të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme truall, me nr. *** (rrjedh nga ish-***), me sipërfaqe 634 m² ndodhur në zonën kadastrale nr. ***, Korçë (në vijim referuar si “pasuria truall 634 m²”)*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Panajoti, ka deklaruar se për blerjen e pasurisë “Apartament banimi 64 m²”, ndër të tjera, ka përdorur depozitën që ka pasur pranë *** Bank, në shumën 20.000 USD, tërhequr më datë ***.10.2007, e cila është krijuar me burim: (i) të ardhura nga punësimi dhe të (ii) ardhura nga shitja e “pasurisë truall 634 m²”, në Korçë, të cilën e trajtojmë në vijim:

26.1.1 Rezulton se më datë ***.10.2007, që korrespondon me datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes për këtë pasuri, subjekti ka tërhequr në *cash* shumën 21.178 USD, pranë *** Bank. Për burimin e krijimit të kësaj depozite, subjekti ka deklaruar: (i) kursimet e mëparshme ndër vite, 600.000 lekë¹⁶, (ii) të ardhurat nga shitja e “pasurisë truall 634 m²”, Korçë, në vlerën 1.775.200 lekë, pjesa takuese sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit¹⁷.

26.1.2 Për sa i përket të ardhurave të deklaruara të përfituara nga shitja e “pasurisë truall 634 m²” Korçë, në vlerën 1.775.200 lekë, nga verifikimi i akteve të administruara në dosje, rezulton se, për të provuar të ardhurat e deklaruara, subjekti ka paraqitur kontratën e datës ***.3.2004, ku si palë shitëse janë znj.***.***, subjekti i rivlerësimit (përfaqësuar me prokurë nga znj.***.***) dhe z.***.***, për çmimin total prej 1.900.000 lekë, si dhe një “Kontratë me premtim shitje në të ardhmen”, të datës ***.5.2003, si palë shitëse dhe nënshkrues janë znj.***.***, subjekti i rivlerësimit dhe z. ***.***, për çmimin total prej 2.000.000 lekë. Rrjedhimisht, pjesa takuese e subjektit e përfituar nga ky transaksion, i takon të jetë në vlerën rreth 560.565 lekë¹⁸ dhe jo në vlerën 1.775.200 lekë, sikundër deklaroi subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit në vitin 2017.

26.1.3 Subjekti i rivlerësimit, znj. Panajoti, lidhur me mospërputhjet e konstatuara sipas kontratave (për pjesën takuese), në shpjegimet e datës 17.6.2019, ka deklaruar se: “... çmimi i shitjes së kësaj pasurie (634 m²), në kontratë nuk është real, por një çmim i reduktuar i propozuar nga noteri dhe që mori miratimin e dy bashkëpronarëve të tjerë dhe blerësit. Qenia ime në këtë veprim juridik vinte në radhë trashëgimie me zëvendësim, ndërkohë që dy shitësit e tjerë ishin pronarë të radhës së parë. Ndaj për mua ka qenë i parëndësishëm edhe caktimi i vlerës në kontratë. Thënë kjo, unë nuk kam deklaruar asnjë herë, që vendosja e këtij çmimi është bërë fiktivisht nëpërmjet dijenisë për të” (f. 28 e shpjegimeve, pika 2).

26.1.4 Komisioni, ka parashtuar se: [...] në rastin konkret nuk mund t'i atribuohet ndonjë sjellje për deklarim të pasaktë subjektit të rivlerësimit, për sa kohë mungon dashja dhe qëllimi për të kryer deklarim të pasaktë, deklarim të rremë apo fshehje pasurie. Nga të gjitha rrethanat faktike dhe nga hetimi administrativ, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në dijeni dhe, rrjedhimisht, në mungesë të anës subjektive, ky ndryshim i çmimit nga një kontratë e mëpasshme nuk mund të konsiderohet sjellje relevante për qëllim të zbatimit të ligjit nr. 84/2016 [...] (f. 17 e vendimit, prg. 2).

¹⁶ Nga historiku i lëvizjeve të këtyre depozitave konstatohet se, fillimisht, është çelur një depozitë në emër të subjektit, në datë 21.6.2002, në shumën 600.000 lekë.

¹⁷ Në datën ***.12.2002 është tërhequr kjo shumë dhe në datë ***.6.2003 është depozituar shuma prej 2.000.000 lekë. Shuma prej 2.060.000 lekë është tërhequr në datë ***.12.2003 dhe në datë ***.12.2003, një ditë më pas, është depozituar shuma 20.000 USD.

¹⁸ Pjesa takuese për sip. 634 m² (2.000.000 lekë/2262 m² * 634 m²).

26.2 Komisioneri Publik vlerëson se arsyetimi i mësipërm i Komisionit nuk qëndron për shkaqet sa vijon:

26.2.1 Komisioni nuk ka evidentuar saktë pasojat e ardhura nga dy kontratat, njëra e datës ***.5.2003 dhe tjetra e datës ***.3.2004, në drejtim të çmimit të vendosur në to. Në kontratën e datës ***.5.2003, në të cilën vetë subjekti i rivlerësimit është nënshkruar i saj, së bashku me dy persona të tjerë, çmimi i kontratës është vendosur 2.000.000 lekë, ndërsa në kontratën e datës ***.3.2004, në të cilën subjekti është i përfaqësuar nga znj.***.***, çmimi i kontratës është 1.900.000 lekë, pra diferenca është 100.000 lekë, ndërkohë që pretendimi i subjektit është për një vlerë vetëm të pasurisë së saj prej 1.755.200 lekë. Në asnjë rast, sipas të dy kontratave të paraqitura, nuk konfirmohet përfitimi i shumës 1.755.200 lekë nga ana e subjektit të rivlerësimit, sikundër është pretenduar prej saj gjatë procesit të rivlerësimit.

26.2.2 Nga aktet në dosje rezulton se as për të ardhurën në shumën 560.565 lekë (pjesën takuese sipas kontratës së datës ***.5.2003), nuk është dokumentuar nga subjekti pagimi i detyrimeve tatimore, në mënyrë që kjo e ardhur të konsiderohet e ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3, e aneksit të Kushtetutës. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk ka provuar me dokumentacion shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurën e realizuar për pjesën takuese sipas kontratave të paraqitura, duke çuar në konkluzionin se ka kryer veprime që cenojnë etikën e magjistratit dhe besimin e publikut te drejtësia, në shmangien e pagimit të drejtë të detyrimeve fiskale, si për pjesën takuese sipas kontratës, ashtu edhe sipas vlerës së pretenduar prej saj.

26.2.3 Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se për të ardhurën nga shitja e pasurisë “Truall 634 m²” Korçë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të remë në D-Vetting, si dhe shuma e deklaruar prej 1.775.200 lekë nuk mund të shërbejë si burim i ligjshëm i krijimit të depozitës prej 20.000 USD dhe, rrjedhimisht, as si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë së paluajtshme “Apartament banimi 64 m²”, Tiranë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime që cenojnë etikën e magjistratit dhe besimin e publikut te drejtësia, duke shmangur pagimin e drejtë të detyrimeve fiskale, si për pjesën takuese sipas kontratës, ashtu edhe sipas vlerës së pretenduar.

26.3 *Për shumën 12.000 euro, depozituar në cash në *** Bank, në vitin 2007*

26.3.1 Rezulton se në datë ***.2.2007, subjekti ka depozituar në *cash* llogarinë e saj në euro pranë *** Bank, shumën 12.000 euro, tërhequr në *cash* në datën ***.10.2007 (një ditë përpara nënshkrimit të kontratës së blerjes së pasurisë apartament 64 m²). Kjo shumë prej 12.000 euro nuk është deklaruar nga subjekti si shumë e poseduar në *cash* në DV-2007.

26.3.2 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës për pamjaftueshmërinë e konstatuar, për të mbuluar me burime të ligjshme shumën 12.000 euro, ka deklaruar se: [...] *...Shuma e depozituar pranë kësaj banke në vitin 2007 ka qenë në vlerën 12.000 euro, të cilat janë depozituar në shkurt 2007 dhe janë tërhequr në tetor 2007. Në këtë periudhë, kjo shumë ka qenë një pjesë e diferencës së vlerave tona monetare të mbetura nga kursimet nga punësimi deri në këtë datë, vlera monetare të kursyera që dispononim në cash në familje, vlera të përfituara nga shitja e tokës në Korçë në vitin 2003, vlera e përfituar nga shpronësimi publik në vitin 2001 etj...[...]* (f. 25 e vendimit, prg. 11 dhe 12). Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në deklaramet e saj, ka theksuar dhe mungesën e detyrimit nga ligji i kohës për deklaramin nga ana e subjekteve deklarues, të disponimit të likuiditeteve në *cash* në DV-2003 e në vijim (ky pretendim do të trajtohet në pikën 31).

26.3.3 Në analizë të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, znj. Panajoti, për krijimin e kësaj shume, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore 2003-2006, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar posedimin e kursimeve në *cash*. Si rrjedhim, nga analiza financiare e subjektit dhe bashkëshortit të saj, për të mbuluar me burime të ligjshme këtë

depozitim, duke marrë në konsideratë të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj për periudhën ***.1.2007 – ***.2.2007, ndryshimet e likuiditeteve në llogaritë bankare për të njëjtën periudhë, tërheqjet në ATM nga të ardhurat nga pagat për periudhën ***.1.2007 – ***.2.2007 (data e depozitimit të shumës 12.000 euro) të bashkëshortit dhe subjektit (në total në vlerën 620.000 lekë¹⁹), **pa llogaritur këtu asnjë shpenzim jetese**, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme shumën e depozituar në datë ***.2.2007, për një diferencë negative prej - 883.840 lekë (1.503.720²⁰ lekë - 620.000 lekë).

26.3.4 Komisioni, ka parashtruar se: [...] *Nisur nga rrethanat konkrete, bashkëpunimi i subjektit të rivlerësimit dhe gatishmëria e tij për të vënë në dispozicion me vërtetësi informacionin e kërkuar, Komisioni vlerëson se parregullsitë formale të konstatuara dhe mungesa e burimit të ligjshëm për shumën 870.873 lekësh nuk janë shkak i mjaftueshëm që plotëson nivelin e kërkuar për qëllim të ligjit nr. 84/2016. [...]*

26.4 Në përfundim për sa më sipër, për shumën e depozituar në vitin 2007, Komisioneri Publik konstaton se deklaratimet e subjektit mbi burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume, paraqiten kontradiktore me deklaratimet e mëparshme, pasi rezulton se të njëjtat burime deklarohen të përdorura edhe për pasuritë apartament 104 m² dhe apartament 64 m². Subjekti i rivlerësimit, në asnjë prej deklaratave periodike vjetore të periudhës 2003-2015, nuk ka deklaruar posedimin e kursimeve në *cash*, në zbatim të detyrimeve të sanksionuara në ligjin nr. 9049/2003, të ndryshuar. Edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të kenë provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe, rrjedhimisht, nuk provohet as mundësia e subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme depozitimin e shumës 12.000 euro për një diferencë negative të paktën prej – 883.840 lekë.

27. Për huan në shumën 10.000 euro

27.1 Në deklaratën e pasurisë për vitin 2007, subjekti ka deklaruar se ka marrë hua, me anë të kontratës së huas me nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2007, noter ***.***, shumën 10.000 euro, personit tjetër të lidhur (babait biologjik të saj), z.***.***.

27.2 Në deklaratën e pasurisë për vitin 2009, subjekti ka deklaruar shlyerjen e plotë të huas, referuar dhe deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.11.2009, notere ***.***.

27.3 Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur me të, huadhënësi, nuk provojnë me dokumentacion justifikues burimin e ligjshëm të huas. Fakt për të cilin, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, i cili, për të provuar të kundërtën, së bashku me përgjigjet e datës 17.6.2019, ka depozituar dokumentacion shtesë mbi të ardhurat e realizuara nga huadhënësi, ku përfshihen edhe të ardhurat familjare të tij, bashkëshortes dhe fëmijëve. Ndër të tjera, subjekti ka depozituar dhe një kontratë shitje të vitit 1996, të apartamentit ekzistues në qytetin e Pogradecit, në vlerën 1.800.000 lekë (kopje e palexueshme).

27.4 Referuar këtij dokumentacioni të administruar, rezulton se të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, huadhënësit, ku janë llogaritur të gjithë të ardhurat e tij familjare, përbëhen nga të ardhurat nga shitja e një pasurie truall në Korçë,²¹ në vitin 1996, të ardhurat

¹⁹ Një shumë prej 570.000 lekësh ka tërhequr bashkëshorti në llogarinë e tij, në *** Bank, dhe 50.000 lekë ka tërhequr subjekti i rivlerësimit në llogarinë e saj në ***, deri në momentin e depozitimit.

²⁰ 12.000 euro, konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë, në datën e kryerjes së depozitimit.

²¹ Subjekti ka pretenduar edhe për të ardhura nga shitja e pasurive truall në Korçë, më të larta se shuma e përcaktuar në kontratën e depozituar. Vlerësojmë se si e ardhur nga ky transaksion duhet të konsiderohet vetëm shuma e caktuar në kontratë dhe jo ajo e deklaruar nga subjekti (rreth 4 herë me e lartë se shuma në kontratë). Për të provuar deklarinë e saj, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale nr. ***, të datës ***.6.2019, të blerësve, shtetasve *** dhe ***.***, në të cilën deklarohet se prona e blerë nga personat e tjerë të lidhur me subjektin, është në vlerën 2.360.600 lekë dhe nuk kanë dijeni se përse në kontratën e shitblerjes (kontratë e firmosur nga vetë ata), kjo vlerë është përcaktuar 569.800 lekë. Kjo mënyrë e të provuarit *a posteriori*, gjatë procesit të rivlerësimit, në raste të ngjashme, nuk është gjetur në përputhje me ligjin, edhe nga jurisprudenca e Kolegjit.

nga shitja e një apartamenti në Pogradec, në vitin 1996²², si dhe të ardhurat nga pensionet respektive, për periudhën 1999-2007. Gjithashtu konstatojmë se, në analizën e pasqyruar nga Komisioni (f. 19 e vendimit), nuk duket që në shpenzimet e personave të tjerë të lidhur të jenë përfshirë dhe shpenzimet e qirasë (nuk është vërtetuar ku kanë jetuar personat e tjerë të lidhur pas shitjes së apartamentit të tyre në Pogradec, në vitin 1996).

28. Jurisprudenca e Kolegjit, lidhur me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit në deklarime

28.1 Nisur nga arsyetimi i Komisionit në vendimin konkret, për mungesën e dashjes dhe qëllimit në deklaratimet e pamjaftueshme, Komisioneri Publik nënvizon se Kolegji ka trajtuar në disa vendime të tij edhe pretendimet e ngritura, lidhur me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit në deklaratimet e subjekteve të rivlerësimit, konkretisht në vendimet (JR) nr. 7/2018, (JR) nr. 9/2019, duke krijuar në këtë mënyrë jurisprudencën vijuese:

- (i) Në vendimin nr. 7/2018, Kolegji përcakton se: [...] *dispozitat kushtetuese dhe ligjore për procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklaratimit me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit... Procesi i rivlerësimit është një procedurë administrative/sanksionuese (dhe asnjëherë një proces penal), e cila ofron të gjitha garancitë e një procesi të rregullt ligjor. Në lidhje me deklarin e pasurisë, ligji nuk ka pasur në qëllim të tij përcaktimin e rrethanave lehtësuese apo rënduese, të lidhura me dashjen apo qëllimin, pasi, në të kundërt, do të kishte bërë përcaktime të tilla si në nenin 38, për standardet e kontrollit të figurës [...].*
- (ii) Në vendimin nr. 9/2019, përcaktohet se: [...] *saktësia e deklaratave të subjektit është e rëndësishme për të kuptuar saktësisht gjendjen reale financiare të tij dhe për të vërtetuar nëse ai ka pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme për krijimin e pasurisë. Jo pa qëllim, ligji e ka ngarkuar subjektin me detyrimin për të kryer deklarin të saktë dhe të plotë. Leximi veçmas apo në harmoni i dispozitave kushtetuese dhe atyre të ligjit nr. 84/2016, përfshirë edhe dy dispozitat e sipërpërmendura, nuk duket se lënë vend që institucionet e rivlerësimit të hetojnë qëllimin e subjekteve në procesin e deklaratimeve të interesave periodike vjetore ndër vite [...].*

29. Në përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, për pasurinë “apartament banimi me sip. 64 m²”, Tiranë, në referencë të nenit D, pika 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, rezulton se: (i) për të ardhurën nga shitja e “pasurisë truall 634 m²”, Korçë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të rremë në D-Vetting, si dhe shuma e deklaruar prej 1.775.200 lekë nuk mund të shërbejë si burim i ligjshëm i krijimit të depozitës me të ardhura të ligjshme prej 20.000 USD dhe, rrjedhimisht, as si burim i ligjshëm i të ardhurave të ligjshme për blerjen e pasurisë së paluajtshme: “Apartament banimi 64 m²” Tiranë; (ii) për depozitën prej 12.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të rremë dhe kjo shumë nuk mund të shërbejë në tërësinë e saj si burim i ligjshëm i të ardhurave të ligjshme për kryerjen e transaksionit për krijimin e pasurisë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime që cenojnë etikën e magjistratit dhe besimin e publikut te drejtësia, duke shmangur nëpërmjet fiktivitetit në çmim, pagimin e drejtë të detyrimeve fiskale, si për pjesën takuese sipas kontratës, ashtu edhe sipas vlerës së pretenduar.

30. Mosdeklarimi i likuiditeteve, kursime në cash

30.1 Në *D-Vett*, subjekti ka deklaruar: gjendje *cash* jashtë institucioneve bankare, në shumën 5.500 euro, me pjesë takuese 50%, secili bashkëshort.

²² Kontrata është e palexueshme.

30.2 Në DV-2016, subjekti ka deklaruar për herë të parë kursime në *cash* jashtë institucioneve bankare, duke deklaruar: *shtuar 3.500 euro*, me pjesë takuese 50%, secili bashkëshort. Nga verifikimi i dokumentacionit mbi të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, rezulton se kursimi i deklaruar në 2016 mbulohet me burime të ligjshme.

30.3 Referuar “Rezultateve paraprake të hetimit administrativ”, Komisioni, bazuar në nenin Ç, pika 5 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, znj. Panajoti, barrën e provës për të provuar mbulimin me burime të ligjshme të shtesës 2.000 euro, të rezultuar si diferencë midis gjendjes *cash* në D-Vett. me atë të DV-2016.

30.4 Subjekti i rivlerësimit, znj. Panajoti, ka deklaruar se shuma prej 2.000 euro ka si burim shitjen e automjetit në datë ****.10.2015*, dhe se *kjo e ardhur është deklaruar në DV-2015 dhe ka qenë gjendje në shtëpi*²³.

30.5 Komisioni, ka parashtruar se: [...] *nga hetimi administrativ nuk pati të dhëna që të ngrinin dyshime për fshehje apo deklarime të rreme lidhur me shumën 5. 500 euro si gjendje cash në banesë. Në vlerësim të këtyre fakteve, Komisioni del në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt në deklarimin e tij në deklaratat përkatëse ndër vite dhe në atë Vetting, dhe i ka pasur mundësitë financiare për të krijuar gjendjen cash në shumën e deklaruar [...] (f. 25 e vendimit, prg. 24.1).*

30.6 Komisioneri Publik konstaton se, në DV-2015, subjekti ka deklaruar vetëm tjetërsimin e pasurisë dhe shitjen e automjetit, por jo disponimin e shumës në *cash*, në formën e kursimit. Nga analiza financiare lidhur me kursimin e deklaruar, rezulton se në datën e dorëzimit të D-Vett, 25.1.2017, në shumën 5.500 euro, të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj për periudhën ****.1.2017 - ***.1.2017*, nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shtesën e kursimit prej 2.000 euro ose 273.560 lekë²⁴. Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, sipas verifikimit të lëvizjeve në llogaritë e pagave për periudhën ****.1.2017 - ***.1.2017*, rezultojnë në shumën 207.753 lekë, të cilat janë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe shtesën në kursimin *cash* të deklaruar. Nga verifikimet e këtyre lëvizjeve rezulton se është tërhequr nga llogaritë në këtë periudhë shuma prej rreth 185.000 lekësh, e cila, edhe nëse konsiderohet që të ketë shkuar e gjitha për kursim, nuk mbulon plotësisht kursimin prej 2.000 euro ose 273.560 lekësh.

30.7 Subjekti i rivlerësimit, znj. Panajoti, lidhur me mosdeklarimet e kursimeve në gjendje *cash*, në deklaratat periodike vjetore, DV-2007 (vit i krijimit të depozitës 12.000 euro, sikundër trajtuar në pikën 27.3, më lart) dhe DV-2015, ka deklaruar se: [...] *nuk ka ekzistuar detyrimi ligjor i deklarimit të vlerës në cash jashtë institucioneve bankare. Ky detyrim daton vetëm në vitin 2014 me ndryshimet e miratuara me ligjin nr. 45, datë 24.4.2014. Gjithashtu, në përmbajtjen e formularëve të deklarimeve periodike në këto vite (2003-2014) nuk kërkohej në asnjë moment deklarimi i vlerës cash jashtë sistemit bankar[...].*

30.8 Komisioni, për mosdeklarimin e *cash*-it nga ana e subjektit, ka parashtruar se: [...] *vërtet subjekti nuk ka deklaruar gjendjen cash në banesë deri në vitin 2015, por të ardhurat e tyre të ligjshme kanë qenë realisht dy deri në tri herë më të larta se shpenzimet e deklaruara. Në përfundim të analizës, Komisioni çmon se, pavarësisht mundësisë reale që subjekti ka pasur për realizmin e këtyre të ardhurave, mosdeklarimi i gjendjes cash në banesë nuk mund të provojë me saktësi se kemi të bëjmë më pasaktësi në deklarim apo me mungesë burimesh financiare të ligjshme. Por, bazuar në të gjitha rrethanat faktike dhe nga hetimi administrativ, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie dhe se nuk ka pasur qëllimin dhe dashjen për të bërë deklarim të pasaktë, deklarim të*

²³ Shpjegime të subjektit, datë 17.6.2019, f. 30.

²⁴ Konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë, në datën e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, 25.1.2017.

rremë apo fshehje pasurie. Ky përfundim arrihet bazuar edhe në faktin se shuma objekt verifikimi (këtu bëhet fjalë për shumën 12.000 euro të vitit 2007) ka qenë e depozituar në bankë, në emër të subjektit dhe nuk u konstatuan veprime të qëllimshme nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Rrjedhimisht, në mungesë të elementit të anës subjektive, kursimi nga burime të ligjshme i një shume parash jashtë sistemit bankar në vitin 2007, duke pasur parasysh edhe kalimin e një kohe të gjatë, si edhe mundësitë reale të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit për të krijuar këto të ardhura, nuk mund të konsiderohet si sjellje që përbën shkak relevant për qëllim të zbatimit të ligjit nr. 84/2016 dhe marrjen e një mase disiplinore [...] (f. 27 e vendimit, prg. 2, 3 dhe 4).

31. Komisioneri Publik vlerëson se detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklarin e çdo pasurie, të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë dhe likuiditetet në formën e *cash*-it, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ky detyrim ka lindur me ndryshimet ligjore pas vitit 2014, nuk gjen mbështetje ligjore. Për më tepër, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, nën këtë logjikë, rezulton se subjekti as në vitin 2015, nuk ka deklaruar likuiditetet prej 2.000 euro, të cilat më pas i pretendon se i ka pasur gjendje të akumuluar deri në momentin e plotësimit të D-Vett.

32. Jurisprudenca e Kolegjit, lidhur me mënyrën e deklarimit në vite të kursimeve në cash

32.1 Kolegji ka trajtuar në disa vendime edhe pretendimet e ngritura lidhur me mënyrën e deklarimit në vite, duke edhe orientuar Komisionin, në bazë të së drejtës së njohur nga pika 2, e nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, konkretisht në vendimet (JR) nr. 7/2019, nr. 11/2019 dhe vendimi i shkurtuar nr. 20/2019, me jurisprudencën vijuese:

- (i) Në vendimin (JR) nr. 7/2019, përcakton se: [...] bazuar në nenin 66, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, **Kolegji orienton Komisionin** që, për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen ...të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike [...].
- (ii) Në vendimin (JR) nr. 11/2019, përcakton se: [...] Referuar nenit 4, pika 1, shkronja “d” e të njëjtit ligj, në objektin e deklarimit, sipas kësaj dispozite, përfshihet në konceptin e pasurisë së deklarueshme edhe vlera e likuiditeteve në gjendje cash, për të cilat, si për çdo pasuri tjetër, duhet të deklarohet gjendja deri më 31 dhjetor, në raport me deklarin e mëparshëm mbi të njëjtën pasuri. [...] Gjithashtu, neni 7 i të njëjtit ligj²⁵ përcakton në mënyrë të shprehur se në deklarin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji. Në përputhje me përcaktimet e mësipërme ligjore, janë miratuar edhe modelet e formularëve të deklarimeve periodike, të cilat, në rubrikën e ndryshimeve të pasurive dhe interesave private, në shpjegimet orientuese për subjektet lidhur me mënyrën e deklarimit, udhëzojnë: Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesat, pakësimet) [...] të çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit. [...].

[...] ²⁵ Para miratimit të përmbajtjes aktuale të këtij neni, me miratimin e ligjit nr. 85/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003”, ky detyrim ligjor përcaktohej shprehimisht në të njëjtën mënyrë nga neni 15, pika 7 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. [...]

(iii) Në vendimin e shkurtuar (JR) nr. 20/2019, përcaktohet se: [...] pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se shlyerja e kësteve të huas dhe kësteve të apartamentit në këto vite është përballuar prej kursimeve të tij në cash, të deklaruara në vitet paraardhëse, por pa u deklaruar pakësimi i kësaj pasurie në deklaratat periodike, është në vlerësimin e trupit gjykues një argument që nuk mbështetet në ligjin nr. 9043/2003 ... i cili ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti rivlerësimi për të deklaruar çdo shtesë e pakësim të pasurisë në çdo formë që ajo ndodh përgjatë një viti periodik [...].

33. Në përfundim për sa më sipër, në referencë të nenit D, pika 1 dhe 5 e aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të kursimeve në gjendje cash në banesë, për vitet 2003-2015 dhe në D-Vetting.

34. Për pasurinë autoveturë “Scoda Octavia”, vit prodhimi 2009, blerë në 2015, në vlerën 9.500 euro

34.1 *Në D-Vett.*, subjekti ka deklaruar: makinë “Scoda Octavia”, vit prodhimi 2009, targa ***, kontratë shitje nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.5.2015, noter ***.***. Vlera 9.500 euro. Në bashkëpronësi, ½ pjesë. *Burimi i krijimit:* kursime nga punësimi.

34.2 *Në DV-2015*, subjekti ka deklaruar: blerë makinë “Scoda Octavia”, kontrata nr. *** rep., nr.*** kol., dt.***.5.2015, noter ***.***. Vlera 9.500 euro. Pjesa takuese, 50%. Nuk deklarohet burimi i krijimit.

34.3 Lidhur me burimin e pagesës në shumën 9.500 euro, konstatojmë se, në kontratën e shitblerjes, në nenin 3, përcaktohet se: “*Palët në marrëveshje kanë përcaktuar çmimin e shitjes në shumën prej 9.500 euro, shumë e cila, sipas deklarimit të vetë palëve, është likuiduar plotësisht nga ana e blerësit, në datën e hartimit të kësaj kontrate, paguar në para fizike, pagesë e cila vërtetohet edhe me mandatpagesën me nr. ***, datë ***.5.2015, nënshkruar nga palët*”.

34.4 Nga lëvizjet e llogarisë bankare të pagës në emër të personit të lidhur, z. Panajoti, pranë *** Bank, rezulton se, në datë ***.5.2015 (1 ditë përpara lidhjes së kontratës), është tërhequr shuma prej 1.000.000 lekësh.

34.5 Komisioni, nuk ka konstatuar problematika lidhur me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, z. Panajoti, për të mbuluar me burime të ligjshme pasurinë automjet.

34.6 Komisioneri Publik, për të vlerësuar nëse subjekti dhe bashkëshorti i saj mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimin e kryer për blerjen e automjetit deri në datën ***.5.2015, në analizë financiare ka marrë për bazë të ardhurat e dy bashkëshortëve dhe shpenzimet e jetesës deri në këtë periudhë, si dhe ndryshimet e likuiditeteve në llogaritë bankare për periudhën 1.1.2015 - 14.5.2015.

34.7 Në përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se, në referencë të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe blerjen e pasurisë autoveturë për një diferencë negative prej – 125.916 lekë.

Tabela nr. 1, Analizë financiare për pasurinë autoveturë “Scoda Octavia”

Periudha 1.1.2015 - 14.5.2015	Shuma në lekë
1. Likuiditet në fillim të vitit (gjendje në bankë)	5.434.824
2. Të ardhurat	1.346.334
2.1 Të ardhurat e subjektit nga paga si gjyqtare ²⁶	546.334
2.2 Të ardhurat e bashkëshortit nga paga ²⁷	800.000
3. Shpenzimet²⁸	497.385
3.1 Shpenzime jetese	336.414
3.2 Shpenzime udhëtimi	160.971
4. Blerje automjeti “Scoda Octavia”, 14.5.2015 (9.500 euro)	1.339.405
5. Likuiditete në fund të periudhës (gjendje në bankë)	5.070.284
6. Diferenca në mbulimin e shpenzimeve (1+2-3-4-5-6)	- 125.916 lekë

III. Kërkimi i ankimit

35. Nisur nga dispozitat e nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, referuar sa ka disponuar Komisioni në rastin konkret, në gjendjen që janë faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, në zbatim të jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt me Komisionin, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

36. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

37. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

38. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr.169, datë 26.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

²⁶ Sipas vërtetimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

²⁷ Sipas shkresës së Drejtorisë të Arkivit Qendror, ISSH, nr. *** prot., datë ***.11.2018.

²⁸ Në analizën financiare, në zërin e shpenzimeve, nuk janë përfshirë shpenzime të tjera, si shpenzime shkollimi/transporti, arredimi etj., sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit.